



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2898 Proa

VENDIM

14.10.2020

NR. 95, DATË 14.10.2020

MBI

**SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA SHOQËRIA
“ABC NEWS” SH.A., PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË ABSOLUTE TË
VENDIMIT NR. 61, DATË 21.08.2020 TË AMA-S “PËR SHQYRTIMIN E
APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ABC NEWS” SH.A., PËR RINOVIMIN E LICENCËS
SË SUBJEKTIT AUDIO PRIVAT VENDOR “ABC NEWS”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “ABC NEWS” sh.a.

Objekt: Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “ABC NEWS” sh.a., për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 61, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “ABC NEWS”.

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 132 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 110, 134 dhe 136, pika 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

VËREN:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 120, datë 28.03.2011, ka licencuar shoqërinë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat “ABC NEWS”. AMA me vendimin nr. 84, datë 16.05.2018, ka rinovuar licencën e këtij subjekti. Afati i vlefshmërisë së licencës ka përfunduar në datën 07.05.2019.

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Mbi procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrin nr. 308, datë 20.11.2019, të Kryetarit të AMA-s, në datë 20.11.2019, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin e shoqërisë “ABC

NEWS” sh.a., me nr. 3721 prot., datë 17.10.2019, për rinovimin e licencës së subjektit audio privat “ABC NEWS”.

Gjatë procedimit administrativ të rinovimit të licencës, subjekti ka njoftuar ndryshime të ndodhura në strukturën e tij të pronësisë, ndryshime të cilat janë miratuar nga AMA, me vendimin nr. 10, datë 29.01.2020. Aksionar i vetëm i shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., është shoqëria “A.B.C. Management” sh.p.k., me 100% të aksioneve.

Lidhur me aplikimin për rinovimin e licencës, pas depozitimit të dokumentacionit plotësues, KSHD, duke e gjetur të plotë dosjen e subjektit, i propozoi AMA-s, rinovimin e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat “ABC NEWS” dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga “Rrethet Tiranë, Durrës, qyteti Fier dhe qarku Vlorë”, në “Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak”, me karakteristikat teknike përkatëse.

AMA, me vendimin nr. 61, datë 21.08.2020 vendosi mosrinovimin e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS” dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS”.

Shkak i kësaj vendimmarrjeje ishte mungesa e arritjes së kuorumit të nevojshëm ligjor për rinovimin e licencës, prej 5 votash.

Në nenin 19, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar, parashikohet: “1. *Funksionet kryesore të AMA-s janë: b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;...*”

Shoqëria “ABC NEWS” sh.a., pasi është njohur me vendimin e AMA-s nr. 61, datë 21.08.2020, ka depozituar ankim administrativ, protokolluar në AMA me nr. 2513/1, datë 29.09.2020, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të lartpërmendur të AMA-s dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS”.

Në këtë ankim administrativ, pala ankuese në mënyrë të përmbledhur parashtron:

“...Bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkesat për rinovimin e licencës së subjekteve audiovizive miratohen ose refuzohen me vendim të AMA-s. Neni 13 i po këtij ligji parashikon se: *mbledhjet e AMA-s janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë.*”. Ndërkohë për lëshimin apo heqjen e licencave nevojitet një shumicë e cilësuar prej 5 (pesë) votash, bazuar në pikën 1 (b) të nenit 19 të po këtij ligji.

Sikurse vërehet në krye po ashtu edhe në dispozitiv të vendimit objekt ankimi, në mbledhjen e AMA-s për nxjerrjen e këtij vendimi kanë qenë të pranishëm vetëm Kryetari, zëvendëskryetari dhe 3 (tre) anëtarë. Ndër këta anëtarë zj. Suela Musta nuk ka marrë pjesë në votim. Kjo është në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i cili parashikon se: “anëtarët e organit kolegjial, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë, përveç organeve të zgjedhura dhe kur parashikohet ndryshe nga ligji”.

Mjafton ky fakt për të bërë që vendimi i marrë nga AMA si organ kolegjial të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm në kuptim të pikës ii) germa a) të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

Sa më sipër, bazuar në gjurmën a(ii) të nenit 108 të Kodit të procedurave administrative, vendimi nr. 61, datë 21.08.2020 i AMA-s është absolutisht i pavlefshëm për shkak të mosrespektimit të procedurës së nxjerrjes së tij

... Ndërkaq pika 3 e nenit 22 të rregullores "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin nr. 187, datë 08.07.2016, të ndryshuar, parashikon në mënyrë shteruese rastet kur AMA refuzon aplikimin e subjektit për rinovim licence, të cilat janë kur subjekte:

- a. Nuk ka respektuar kushtet e licencës gjatë periudhës së licencimit;
- b. Është debitor lidhur detyrimet financiare të lindura nga licenca;
- c. Është debitor si rrjedhojë e dënimit me gjobë, të formës së prerë të pashlyer.

...Përfundimisht, bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, pranimin e këtij ankimi administrativ, duke vendosur si më poshtë:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 61, datë 21.08.2020 të AMA-s njoftuar me shkresën nr. 2513 prot., datë 08.09.2020 të AMA-s nëpërmjet të cilit është vendosur "Mosrinovimi i licencës së shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për subjektin audio privat vendor "ABC NEWS". Konstatimi i pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për subjektin audio privat vendor "ABC NEWS".
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., për subjektin audio privat vendor "ABC NEWS".

AMA konstaton se bazuar në nenin 132 pika 4 të ligjit të posaçëm nr. 97/2013, të ndryshuar: "Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 30 ditëve". Po ashtu, në nenin 134 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se përveçse kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi ndaj një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin si dhe ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Lidhur me shkaqet e parashtruara në ankim, në nenin 13 të ligjit tonë organik, parashikohet se: "2. Vendimet e AMA-s merren kur për to votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj" Ndërsa në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohet se AMA lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar. Neni 25 i rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 209, datë 16.09.2016, i ndryshuar, përcakton se: "Autoriteti i Mediave Audiovizive, i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet shumicë e cilësuar."

Në mbledhjen e AMA-s të datës 21.08.2020, kur është miratuar edhe vendimi për shqyrtimin e aplikimit të palës kërkuese, kanë qenë të pranishëm 5 anëtarë dhe ndarja votive ka rezultuar:

- 4 anëtarë kanë qenë pro rinovimit të licencës për subjektin aplikues;
- 1 anëtar, nuk ka marrë pjesë në votim, duke abstenuar.

Në marrjen e vendimit për mosrinovimin e licencës për shoqërinë "ABC NEWS" sh.a., AMA argumentoi se në kushtet kur AMA është organ kolegjal i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, për të miratuar dhënien e licencës së transmetimit audio private lokale nevojitet një shumicë e cilësuar prej 5 votash, shumicë, e cila eventualisht, mund të arrihet/plotësohet edhe pse AMA

aktualisht funksionon dhe ushtron aktivitetin e tij administrativ dhe vendimmarrës me 5 anëtarë, pra jo me anëtarësi të plotë (pasi 2 vende janë vakante).

Abstenimi nga votimi i një prej anëtarëve të AMA-s, bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, konkretisht nenin 12, të tij që parashikon Votimin e detyrueshëm. Sipas këtij neni: “Anëtarët e organit kolegjial, qe janë te pranishëm ne mbledhje dhe qe nuk kane ndonjë pengese ligjore për te votuar, nuk mund te abstenojnë, përveç organeve te zgjedhura dhe kur parashikohet ndryshe nga ligji. Kryetari i organit kolegjial voton i fundit.”.

AMA vëren se në nenin 110 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”*.

Sa më sipër, në mbështetje të dispozitave të cituara më lart të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, AMA ka të drejtë të konstatojë pavlefshmërinë e vendimit të tij nr. 61 datë 21.08.2020 me të cilin është vendosur mosrinovimi i licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS”.

Me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të tij nr. 61, datë 21.08.2020, akt i cili konsiderohet i paqenë ose nul, AMA do të procedojë me shqyrtimin e aplikimit të subjektit, shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për rinovimin e licencës për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS”.

Për sa u trajtua më lart, AMA merr në konsideratë ankimin e paraqitur nga subjekti,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 110, 113 dhe 136, pika 4 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S I :

1. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., duke vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 61, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “ABC NEWS”
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., me NIPT: K01711004F dhe Administrator z. Idaver Sherifi, për subjektin audio privat “ABC NEWS”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
3. Reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga “Rrethet Tiranë, Durrës, qyteti Fier dhe qarku Vlorë”, në “Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak”, me karakteristikat teknike të pikës së transmetimit në Fushë Dajt, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur.
4. Subjektit i hiqet e drejta e përdorimit të frekuencave, në pikat e transmetimit Fier (qytet) (88.8 MHz), Zvërnec (101.4MHz), Llogara (104.5 MHz), Treblovë (104.9 MHz), Tërbaç (103.2 MHz) dhe Mile (105.9 MHz).

5. Kushtet e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat “ABC NEWS”, përveç kushteve teknike, mbeten të pandryshuara.
6. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Pika 2 e këtij vendimi i shtrin efektet prej datës 07.05.2019, ndërsa pikat e tjera hyjnë në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

Handwritten signatures in blue ink corresponding to the names listed in the table. The signatures are written over the printed names and are somewhat stylized and overlapping.

Aneksi 1

Karakteristikat teknike të pikës së transmetimit në Fushë- Dajt

<i>Zona e shërbimit</i>	<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat XYZ</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Përforcimi i antenës (dBi)</i>	<i>ERP (W)</i>	<i>Azimuth (deg)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak	Fushë Dajt	105	19.55177 41.21257 1179 4DMS	500	8	1132.739	270	20	D